



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Tiranë, më 22.12.2017

NJOFTIM

“PËR NGRITJEN NË DETYRË NË KLSH”

Në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 152/2013, datë 01.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”, si dhe Vendimin nr. 4, datë 27.01.2017 të Kryetarit të KLSH “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar;

Ju njoftojmë se:

Kanë filluar procedurat për ngritje në detyrë përkatësisht për:

I. Për pozicionin e Drejtorit të Departamentit/Drejtorisë.

Në konkurrim ftohen të marrin pjesë Kryeaudituesit që plotësojnë këto kritere:

- të kenë eksperiencë pune në KLSH
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë rezultate pozitive në auditime;
- të kenë dhënë kontribut në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista (përkthime) të ndryshme etj.

II. Për pozicionin e Kryeaudituesit në Departament Auditimi.

Në konkurrim ftohen të marrin pjesë Audituesit e Lartë që plotësojnë këto kritere:

- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë rezultate pozitive në auditime;
- të kenë dhënë kontribut në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista (përkthime) të ndryshme etj.

III. Për pozicionin e Audituesit të Lartë në Departament Auditimi.

Në konkurrim ftohen të marrin pjesë Audituesit e I (parë) që plotësojnë këto kritere:

- të kenë eksperiencë pune në KLSH
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë rezultate pozitive në auditime;
- të kenë dhënë kontribut në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista (përkthime) të ndryshme etj;

IV. Për pozicionin e Audituesit të I(parë) në Departament Auditimi.

Në konkurrim ftohen të marrin pjesë Audituesit e II (të dytë) që plotësojnë këto kritere:

- të kenë eksperiencë pune në KLSH
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë rezultate pozitive në auditime;
- të kenë dhënë kontribut në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista (përkthime) të ndryshme etj.

Të gjithë të interesuarit duket të paraqesin kërkesën e tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore deri më **datë 31 Dhjetor 2017**.

Kërkesa duhet të shoqërohet me një prezantim të performancës gjatë kryerjes së veprimtarisë audituese (prezantimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të rëndësishme, dëmit ekonomik, kallzime penale etj), kontributit në botime të ndryshme të KLSH-së, artikuj të ndryshëm për 2 vitet e fundit.

Testimi për ngritje në detyrë do të zhvillohet bazuar në rezultatet e punës audituese, nga vlerësimi i dosjeve individuale, si dhe intervista e strukturuar me gojë nga Komiteti i Pranimit Për Ngritjen në Detyrë.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE